



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	08.11.2021
Referenc-ë:	07-353/04-237021/21
Për/ Za/ To:	“Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë”
Përmes/Preko/Through:	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtorija për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr protokolli 07-353/04-237021/21 nga “Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë” (KIESA) me të cilën kërkohet që me datë 02,03 dhe 04 Dhjetor 2021 nga ora 09:00 deri në 18:00 të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike në sheshin “Adem Jashari”.

Qëllimi i kërkesë është mbajtja e panairit tradicional “Gratë në Biznes” ku do të marrin pjesë rreth 30 biznese dhe shoqata të grave ndërmarrëse.

Drejtorija pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë”(KIESA) për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin “Adem Jashari” me datë 02,03 dhe 04 Dhjetor 2021 nga ora 09:00 deri në 18:00 për mbajtjen e panairit tradicional “Gratë në Biznes” sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Mos të pengohet lëvizja e lirë e qytetarëve;
- Pas përfundimit të aktivitetit hapësira të kthehet në gjendjen e më parshme;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.